

V E N D I M
Nr.93, datë 13.5.2002

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci	Anëtar i “““
Gjergj Sauli	Anëtar i “““
Alfred Karamuço	Anëtar i “““
Kristofor Peçi	Anëtar i “““
Kujtim Puto	Anëtar i “““
Tefta Zaka	Anëtare e “““
Sokol Sadushi	Anëtar i “““
Petrit Plloçi	Anëtar i “““

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 27.2.2002, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.40 Akti që i përket:

K Ë R K U E S:XHAVIT ÇELIKU, etj., përfaqësuar nga avokatët Dilaver Rexhepi e Nexhdet Kambo, me prokurë.

SUBJEKTE Të INTERESUARA:XHELADIN E EQEREM QAZIMI, përfaqësuar nga avokat Fatmir Braka, me prokurë.

O B J E K T I:Shfuqizimi si antikushtetues i vendimeve nr.2, datë 25.10.1999 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.160, datë 27.2.2001 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE:Nenet 42 e 131/f të Kushtetutës.

Për shfuqizimin e vendimeve të mësipërme, kërkuesi ka parashtruar:

Të dyja gjykatat, në vendimet e tyre kanë konkluduar se çështja përbën gjë të gjykuar, duke lënë në fuqi një vendim që nuk i ka dhënë zgjidhje themelit. Në rastin në shqyrtim nuk ka gjë të gjykuar sepse gjykata është vënë në lëvizje me një padi të re, me objekt tjetër dhe palë të tjera.

Duke pranuar sa mësipër, megjithëse çështja nuk është zgjidhur në themel, gjykatat kanë hequr çdo mundësi për të rivënë në lëvizje gjykatën, duke i cenuar kështu të drejtën për një proces të rregullt ligjor.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Petrit Plloçi, përfaqësuesit e kërkuesve, të subjekteve të interesuara dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Gjykata e Rrethit Tiranë, me vendimin nr.4552, datë 28.12.1998, ka vendosur pranimin e padisë, duke detyruar të paditurit të njohin kërkuesin Xhavit Çeliku pronar mbi truallin.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.2, datë 25.10.1999, ka vendosur prishjen e vendimit të mësipërm të Gjykatës së Rrethit Tiranë dhe rrëzimin e padisë si gjë e gjykuar.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.160, datë 27.2.2001, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të mësipërm të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Në këto kushte, kërkuesi Xhavit Çeliku, ka kërkuar shfuqizimin si antikushtetues të vendimit të fundit të Gjykatës së Apelit, si dhe të vendimit të Kolegjit Civil, duke pretenduar se i është shkelur e drejta për një proces të rregullt ligjor, parashikuar nga nenit 42 i Kushtetutës. Sipas kërkuesit, duke

pranuar se çështja përbën gjë të gjykuar, atij i është hequr mundësia për t'iu drejtuar për zgjidhjen e këtij konflikti.

Pretendimi i kërkuarit se, në rastin në shqyrtim, çështja përbën gjë të gjykuar i referohet vlerësimit të provave të bëra si nga gjykata e apelit, ashtu edhe Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë e, si i tillë, nuk mund të investojë Gjykatën Kushtetuese. Me këtë rast, Gjykata pohon edhe një herë qëndrimin e saj se mënyra e vlerësimit të provave është atribut i gjykatave të zakonshme që zgjidhin çështjen konkrete dhe nuk i nënshtrohet kontrollit të saj kushtetues. Sfera e kompetencave të kësaj Gjykate, në rastet kur shqyrton kërkesat e individëve, është e kufizuar. Në vështrim të nenit 131/f të Kushtetutës, ajo gjykon çështje të tilla, por vetëm në rastet e shkeljes të së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Shkelje të tilla nuk kanë të bëjnë as me zbatimin e ligjit material e as me mënyrën e vlerësimit të provave nga gjykatat e zakonshme.

Përsa sipër, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se kërkesa e paraqitur duhet të rrëzohet.

PËR KETO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131/f të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.